

MEMORANDUM BASHKËPUNIMI

NDËRMJET

MINISTRISË SË PUNËVE TË BRENDSHME TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

DHE

MINISTRISË SË PUNËVE TË BRENDSHME TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

MBI FORCIMIN E BASHKËPUNIMIT NË FUSHËN E KONTROLLIT TË BRENDSHËM

Ministria e Punëve të Brendshme e Republikës së Kosovës nëpërmjet Inspektoratit Policor të Kosovës, si agjenci të zbatimit të ligjit të cilat zhvillojnë aktivitetin e tyre në fushën e kontrollit të brendshëm dhe Ministria e Punëve të Brendshme e Republikës së Shqipërisë nëpërmjet Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat.

- Në kontekstin e perspektivës evropiane të të dy vendeve,
 - Të drejtuar nga dëshira për ta nxitur më tej bashkëpunimin dypalësh në fushën e mbikqyrjes policore dhe kontrollit të brendshëm,
 - Në interes të sigurisë së shtetasve të Republikës së Shqipërisë, si dhe të shtetasve të Republikës së Kosovës në këndvështrimin e një lufte me eficientë kundër korrupsionit brënda rradhëve të policisë si dhe në respektimin e të drejtave dhe lirive të individit,
 - Bazuar në të Drejtën Ndërkombëtare si edhe në legjislacionin kombëtar të shteteve respektive në kontekstin e bashkëpunimit, palët bien dakord si më poshtë vijon:
1. Të përmirësojnë bashkëpunimin në fushën e shërbimeve të kontrollit të brendshëm në të dy vendet, me qëllim rritjen e efektivitetit dhe efikasitetit të luftës kundër korrupsionit në rradhët e policisë si dhe respektimin e të drejtave dhe lirive të individit.
 2. Bashkëpunimi duhet të përfshijë masa parandaluese por edhe represive për të luftuar sjelljen korruptive të oficerëve të policisë, duke vendosur theksin në ata punonjës të policisë të cilët janë të përfshirë në krimin e organizuar, trafikimin e qenieve njerëzore dhe emigracionin e paligjshëm, prodhimin e paligjshëm, transportin dhe trafikun e lëndëve narkotike, substancave psikotrope dhe prekursorëve të tyre, e gjithashtu të respektojë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut konform ligjeve në fuqi.

3. Me qëllim forcimin e bashkëpunimit, Ministritë synojnë të zbatojnë aktivitetet e mëposhtme:

- a) Sigurimin e një platforme për shkëmbimin e informacionit dhe ekspertizës në lidhje me çështjet e mbikqyrjes policore dhe anti-korrupsion, nëpërmjet takimesh në nivel ekspertësh;
- b) Bashkëpunim të drejtpërdrejtë dhe mbështetje reciproke, në fushën e asistencës teknike dhe ndërtimit të kapaciteteve si instrumente kryesore të luftës kundër korrupsionit.
- c) Masa trajnuese të përbashkëta, duke vërejtuar se edukimi, formimi profesional dhe kërkimi anti-korrupsion janë komponentë të rëndësishëm të ndërtimit dhe forcimit të kapaciteteve anti-korrupsion;
- d) Veprime operacionale të përbashkëta, për zbulimin, dokumentimin dhe goditjen e veprimtarisë anti-ligjore të kryer nga punonjës policie të dy vendeve tona;

4. Palë të treta mund të marrin pjesë në këtë bashkëpunim ndërmjet dy Ministrive duke marrë ftesën për këtë qëllim, në mënyrë të veçantë vende të tjera- shtetet anëtare të BE, shtete në proces anëtarësimi, shtete me statusin e kandidatit për anëtarësim në BE dhe shtete anëtare të EPAC-ut.

5. Ministritë kanë si qëllim të vazhdojnë zbatimin e projekteve të përbashkëta të cilat janë në proces dhe kur të jetë e nevojshme, në varësi të mundësive, të nisin projekte të reja brenda bashkëpunimit rajonal dhe evropian.

6. Ky bashkëpunim duhet të nxisë afrimin e Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Kosovës drejt normave dhe standardeve të Bashkimit Evropian; bashkëpunimi duhet të zhvillohet në përputhje me to dhe në përputhje me progresin e të dyja vendeve për përmbushjen e standardeve dhe normave në polici sipas standardeve të Bashkimit Evropian në përgjithësi dhe të Kodit Evropian të Etikës Policore në veçanti.

7. Ministritë shprehin vullnetin e tyre për ta zgjeruar më tej bashkëpunimin brenda fushave të tyre të kompetencës si edhe të zhvillojnë forma të reja bashkëpunimi.

8. Me nënshkrimin e këtij Memorandumi Bashkëpunimi, përfaqësuesit e të dy Ministrive duhet të specifikojnë detajet e implementimit të Memorandumit të Bashkëpunimit.


9. Drejtuesit në ngarkim të Shërbimeve përkatëse të Kontrollit të Brendshëm janë përgjegjës për implementimin e këtij Memorandumi nëpërmjet nënshkrimit të protokolleve dhe dokumenteve të tjera operacionale e ligjore.

10. Ministritë synojnë të bëjnë vlerësime dhe nëse shihet e nevojshme të përmirësojnë bashkëpunimin në takime të nivelit ministror dhe në nivel ekspertësh.

Ky Memorandum do të hyjë në fuqi ditën e nënshkrimit të tij.

Nënshkruar në Tirone, më, 23/03/2015 në dy kopje origjinale, në gjuhët shqip, anglisht dhe serbisht, ku tekstet janë njëloj autentike. Në rast të dallimeve në interpretim, do të mbizotërojë versioni në gjuhën shqipe.

PËR
MINISTRINË E PUNËVE TË BRENDSHME
TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS



PËR
MINISTRINË E PUNËVE TË BRENDSHME
TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

